

NE 1934 MIRASH IVANAJ I KERKONTE HOLLESI MBI NGRITJEN E FLAMURIT NE VLORE

Suplementi i së dielës te SHQIPTARJA.com

E-mail: rilindasi@gmail.com

RILINDASI

Viti II - Nr:47

E diel, 2 dhjetor 2012

Kryeredaktore: Admirina PEÇI


Na ndiqni
edhe
online

www.shqiptarja.com

KUJTIMET E LEF NOSIT Çfarë dëshmish la për flamurin e Pavarësisë

Dr. Ledia Dushku

Ishte 23 nëntor i vitit 1912, kur Lef Nosi së bashku me Mid'hat Frashërin e Shefqet Dainë pasi morën mandatin për të përfaqësuar Elbasanin në Kuvendin e Vlorës, nisën rrugëtimin e tyre në drejtim të qytetit bregdetar, ku pritej të ngrihej flamuri kombëtar. Së bashku me ta udhëtonin edhe përfaqësuesit e Kosovës, Sali Gjuka e Bedri Pejani. Pasi fjetën një natë në Godolesh në çifligun e Dhimitër Dashit vazhduan udhëtimin e tyre pa e ditur se në lundrën e Petovës, historia do t'i kishte rezervuar një surprizë: takimin me Ismail Qemalin. Që nga ky moment delegatët e Elbasanit dhe të Kosovës do t'i bashkëngiteshin karvanit të tij drejt Vlorës. Qemal Karaosmani, një tjetër delegat i Elbasanit, shokëruar i Ismail Qemalit nga Durresi, në kujtimet e tij të botuara në gazetën Arbëria në vitin 1936,



Në foto: Lef Nosi si Kryetar i Kuvendit dhe faksimile e një letre dërguar Lef Nosit ku i kërkohen të dhëna rreth flamurit që u ngrit nga Ismail Qemali dhe përgjigja e tij rreth këtyre pyetjeve

do ta përshkruante kështu mormentit e mësipërm:

"Po sa mbëritëm tek lundra e Petovës, mbasi në atë kohë nuk ekzistonin ura nëpër lumenj, u takuam me delegatët e Elbasanit dhe të Kosovës: Lef Nosi, Shefqet Dau, Mid'hat Frashëri, Sali Gjuka dhe Bedri Pejani...Kur delegatët e përmendur ishin duke u fjalosur me I. Qemalin, ne që ishim të armatosur ca e ca u hodhëm në lundra dhe kaluam në anën tjetër të lumit. Në këtë moment prej buzës së malit dolën disa gjindarmë dhe u drejtuan drejt Plakut që kishte mbetur pa kaluar, bashkë me delegatët e Elbasanit...Në të kthyesen e lundrave për të marrë I. Qemal Benë me delegatët e Elbasanit, vrapuan edhe disa prej nesh që ti vinin në ndihmë, por kur mbëritëm në mes të lumit, gjandarët u avitën dhe u dolli përpara Lef Nosi e u fjalos me ta, pastaj i mori dhe i pruri ke I. Qemali që e nderuan dhe...

vijon në faqen 14-15

San Giorgio Lucano, Shën Pali Shqiptar dhe kërcimi i drapërit

Pietro Abitante

Do San Giorgio Lucano është një fshat me origjinë shqiptare, apo jo? Nëse dëgjoni sanxhorhezët duket se jo: "Në lidhje me themelimin e San

Giorgio Lucano dhe emrin e tij, disa mendojnë se fshati është themeluar nga shqiptarët dhe se emri original ishte Minullo. Nuk është e vërtetë!", duket se thotë, gati i mërziut, Benito Carlomagno në tekstin e tij "San Giorgio

Lucano: historia, ambienti dhe folklori" (Ed. Montemurro, Matëra, 1962, pag. 13). Në numrin e Rilindasit të 26 gushtit në lidhje me origjinën shqiptare të San Giorgio Lucano, duke iu referuar një të...

faqe 18-17

Mustafa Merlika Kruja, portreti i një atdhetari dhe studiuesi

Mustafa Kruja hyri në historinë shqiptare si një emër i yver për të mbetur në të pavarësisht ndodhive të kohës. Jeta e tij është intensive me veprimtari atdhetare e politike e njëherazi dhe si studiues i pasionuar...

Nga Aleksandër Meksi

Mustafa Kruja hyri në historinë shqiptare si një emër i yver për të mbetur në të pavarësisht ndodhive të kohës. Ai shquhet si atdhetar qysh në rini në vitet e shkollës, merr pjesë si drejtues në Kryengritjen e Madhe shqiptare të vitit 1912 që parapriu Pavarësinë, përfaqëson Krujën në Vlorë. Jeta e tij është intensive me veprimtari atdhetare e politike e njëherazi dhe si studiues i pasionuar. Mustafa Merlika Kruja lindi më 15 mars 1887 në Krujë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndër-sa shkollën e mesme e kreu në Janinë, në gjimnazin turk të atyshëm ku, në përfundim të studi-

meve, u klasifikua i pari.
- Më 1910, pasi fitoi konkursin e pranimit, u regjistrua në universitetin Mylkije të Stambollit ku përfundoi studimet për shkencat politike dhe administrative me rezultate të shkëlqyera.
- 1911, filloi punën si mësues në gjimnazin e Durresit prej nga largohet për veprimtari atdhetare. Stambolli kërkoi ta internojë në Irak.
- Më 1912, mori pjesë aktive në Kryengritjen e madhe të Kryengritjes kundër Perandorisë Osmane dhe ishte koordinatori i saj për Shqipërinë e Mesme.
- 28 Nëntor 1912, si delegat i Krujës, merr pjesë në Kuvendin e Vlorës në Shpalljen e...

faqe 18-19



"Si depërtuan sllavët në zonat shqiptare në veri e verilindje"

Pjesa e dytë e dokumentave mbi projektin e Musolinit . Autorët e promemorisë së 1941, tregojnë kufijtë, numrin e banorëve dhe tendencën e sllavëve për të depërtuar në zonat shqiptare

faqe 19-20

Adem Jashari, monumenti në Maqedoni që shpërftyron heroin

Është realizuar nga një mësues i ciklit të ulët në tetovë. Thirrja: Të hiqet sa më parë dhe një figurë skulpturore apo imazh dinjitoz t'i kushtohet Adem Jasharit në Radushë të Maqedonisë

Suzana Varvarica Kuka

Pse drejtë e mori do të vazhdojnë të ndodhin me ne shqiptarët kaq bëma, prej të cilave, të vjen të pëshpëllloheshe dhe të ngatërrosh me së pari me identitetin tonë në histori dhe, mandej me veten në kohësinë kulturore të ditëve tona? Dhe kur lidhet kjo ofshamë me krijimtarinë shqiptare monumentale të shekullit XXI, si dhe drejtëpërdrejtë me imazhin e turpshëm tredimensional, kushtuar Adem Jasharit në Radushë të Maqedonisë, atëherë, ajo ofshama individuale, duhet të kthehet në një britmë qytetare shqiptare, që t'i kujtojë atij që e ka kryer atë imazh, të shkojë e ta shkëlqë men-

jëherë e le të mendojë se e ka turpëruar kombin e shqiptarëve në këtë 100 vjetor. Mendoj se ky është një apel për politikanët shqiptarë të Maqedonisë, të cilët kanë pranuar që ky pseudo monument të ngrihet në një vend ku banojnë shqiptarë. Për të ngritur një monument, vendin dhe kohën kur vendosim ta ndërtojmë, duhet të mendojemi shumë mirë. Ata duhet të jenë të një cilësie të lartë dhe pa asnjë ekuivok të dyshuar historik dhe artistik. A e shohin politikanët dhe artistët shqiptarë të Maqedonisë se çfarë po bënë politika dhe administrimi artistik maqedonas, për të memorizuar në Shkup, figurat dhe...

faqe 17

HISTORIA | E PLOTË

LEF NOSI

Çfarë dinte dhe ç'dëshmi la për flamurin e Pavarësisë

Dr. Ledia Dushku

vijon nga faqja 13

...i puthën dorën...Prej andej mbërritëm në Fier, tek Ymer Vriorni, ku hëngrëm drekën. Për darkë nuk qëndruam sepse I. Qemali tha se duhej të shkonim një orë e më parë në Vlorë... Mbas orës tre u nisëm nga Fieri dhe vajtëm në lundrën e Vjosës dhe si kaluam, hymë në rajonin e Vlorës, ku kishin dalë për të na pritur shumë persona... Në qytet mbërritëm nga ora 9 e natës allafrenga...."

Më 28 të vjeshtës së tretë, atë ditë enjte, shiu nuk i pengoi shqiptarët të hidhnin një hap të rëndësishëm për të ardhmen e tyre politike: të shpallnin mëvetësinë e mëmëdheut të tyre. 35 vjeçari Lef Nosi do të bëhej kështu protagonist i njëres prej ngjarjeve më madhore në historinë tonë kombëtare. Si pjesëmarrës aktiv në punimet e Kuvendit të Vlorës, Nosi ishte gjithashtu edhe një ndër nënshkruesit e Aktit të Pavarësisë si dhe anëtar i kabinetit të Ismail Qemalit. Protagonizimi i tij në këtë ngjarje nuk ishte i rastësishme. Formimi i shëndoshë intelektual dhe ndjenjat e spikatura atdhetare ishin shtysat kryesore që i kishin dhënë rolin e protagonistit pinjollit të Nosit edhe më parë. Kishin vite që veprimtaria e tij politike kishte dalë nga dimensioni lokal duke përfshirë një dimension më të gjerë, atë kombëtar. Lef Nosi ishte një nga figurat qëndrore që kontribuan në organizimin dhe zhvillimin në vitin 1909 të Kongresit Arsimit Kombëtar të Elbasanit dhe në çeljen po aty të së parës shkollë normale në Shqipëri.

Ai dallohej edhe si koleksionist e gjurmues i përkushtuar i akteve më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Si rrallëkush nga bashkëkohësit e tij, ai u kujdes dhe punoi me përkushtim mahnitës për grumbullimin, ruajtjen dhe botimin e elementëve të trashëgimisë historike e kulturore të shqiptarëve, duke u bërë kështu njëri prej atyre që hodhi themelet e Arkivit të Shtetit Shqiptar.

Për sa më sipër Lef Nosit shpesh herë i kërkohej mendimi në lidhje me ngjarjet të ndryshme historike, apo dokumente që kishin të bënin me legjislacionin shtetit shqiptar. Do të përmendja këtu dy momente: së pari vitin 1929, kur Këshilli i Lartë i Shtetit, kërkonte përkrahjen e Lef Nosit, për dorëzimin e kopjeve të urdhrave, vendimeve, ligjeve dhe rregulloreve të periudhës 1912-1914. Momenti i dyti, i përket fundit vitit 1934, kohë kur ministri i Arsimit, Mirash Ivanaj i kërkonte Lef Nosit versionin e tij në lidhje me flamurin e ngritur nga Ismail Qemali, pasditen e 28 nëntorit 1912.

Historia e plotë dhe gjithë variantet që qarkullojnë për të vërtetën e flamurit. Pse ministri Mirash Ivanaj e kërkonte të vërtetën nga Lef Nosi, dhe për ç'detaje e pyeste...



Në vitin 1929, Këshilli i Lartë i Shtetit, kërkonte përkrahjen e Lef Nosit, për dorëzimin e kopjeve të urdhrave, vendimeve, ligjeve dhe rregulloreve të periudhës 1912-1914.

Në foto: Lef Nosi si Kryetar i Kuvendit

Për fat të keq, nga dita e madhe historike e pavarësisë, nuk janë ruajtur elementet më të rëndësishëm të saj. Shtëpia ku u mbajt Kuvendi Kombëtar i Vlorës nuk ka mundur t'i rezistojë kohërave. Nuk dimë ku është Deklarata origjinale e Pavarësisë, nuk kemi bisedimet origjinale të Kuvendit Kombëtar të Vlorës dhe as një foto të asaj dite. Madje edhe në vitin 1932, fotoja e festimeve të një vjetorit të Pavarësisë paraqitej në shtypin e kohës si foto e 28 nëntorit të 1912.

Të njëjtin fat ka edhe flamuri i Pavarësisë. Çështja e flamurit të ngritur nga Ismail Qemali ka një histori të gjatë, që është koklavitur në vite. Nga fundi i viteve 20 e deri në fund të atyre 30, në një hark kohor prej jo më shumë se 10 vitesh, variantet në lidhje me këtë flamur e kalojnë numrin 10. Tre janë arsyet e kësaj dukurie: sensi i lartë i protagonizmit tek sh-

Në kërkim të flamurit


Intensiteti i kërkimeve për flamurin shtohet në mes të viteve 30. Spikat këtu puna e gmuar e beratasit Sotir Kolea, drejtor i Muzeut dhe Bibliotekës Kombëtare që nga viti 1928. Ai u përpoq shumë për gjetjen e flamurit dhe ekspozimin e tij në stendat e Muzeut Kombëtar. Por puna rezultoi e vështirë

qiptarët, marrëdhënia problematike me të vërtetën dhe memoria e shkurtër historike. Po kaq janë edhe variantet që meritojnë të mer-

ren në konsideratë.

1. Flamuri u përgatit nga Marigo Pozio, çka do të thotë që zonja Pozio e qëndisi, e stampoi ose e ngjiti shqiponjën në flamur. Në një shkrim rreth ligjit të veteranëve në Gazeta e Re, më 9 dhjetor 1928 Kristo Floqi, ngre zërin për faktin se Marigo Pozio, veprimtare e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, njëkohësisht qëndistare e flamurit të ngritur nga Ismail Qemali, nuk merrte shpërblimin e veteranit. Pak ditë më pas po në të njëjtën gazetë, një korrespondencë nga Vlorë mbështet thëniet e Kristo Floqit. Më 28 nëntor 1933 është sërish Kristo Floqi ai që përmend emrin e Marigosë si qëndistare jo vetëm të flamurit të ngritur nga Ismail Qemali por të të gjithë flamujve të ngritur në godinat qeveritare atë ditë të vjeshtës së tretë, duke i dhënë këtij varianti elementë mitikë.

2. Varianti i dytë ka si protagonist kushërinjtë Eqerem dhe Xhemil Vlorë. Del si i tillë në fillim të viteve 30, kur Eqerem Vlorë vihet në dijeni për një hetim të bërë në Vlorë në fund të vitit 1929. Rezultatet e këtij hetimi na vijnë në kohë nga studiuësja Valentina Duka, e cila ka parë korrespondencën e atyre viteve të ministrisë së Punëve të Jashtme me pinjollin e Vlorajve, duke arritur në përfundim që flamuri i ngritur në Vlorë nga Ismail Qemali ishte marrë nga shtëpia e Eqerem bej Vlorës. Mbështetëse e këtij varianti është baronesha Amalia Von Godin, e cila pretendon se ishte ajo që e kishte marrë flamurin nga koka e krevatit të Eqerem Vlorës dhe ia kishte dorëzuar personave që e kërkonin, sepse ky i fundit në atë kohë ndodhej në Himarë, në krye të një garnizoni osman që organizonte mbrojtjen nga grekët. Ky flamur



Në foto: Faksimile e një letre dërguar Lef Nosit ku i kërkohej të dhëna rreth flamurit që u ngrit nga Ismail Qemali dhe përgjigjia e tij rreth këtyre pyetjeve

ishite dhuruar në vitin 1909 nga Aladro Kastrioti, një nga pretendentët e fronit shqiptar në vitin 1914. Flamuri ishte i leshtë dhe kishte përmasa të vogla.

Në vitin 1935 vetë Eqerem Vlora ka lëshuar një deklaratë në prani të drejtorit të Muzeut Kombëtar, Sotir Kolea dhe Ministrin të Arsimit, Mirash Ivanaj. Në dallim nga deklarata vitit 1930, tashmë bëhej fjalë për dy flamur njëri i tij dhe tjetri i kushëririt Xhemil Vlorës, në shtëpinë e të cilit ishte ngritur flamuri, atë pasdite të 28 nëntorit 1912. Flamurin e Eqerem Vlorës, Ismail Qemali e kishte varur me dorën e tij në dritaren e shtëpisë ku u mbajt Kuvendi i Vlorës. Pas dy ditësh, ky flamur ishte ngulur në derën e shtëpisë së Xhemil Vlorës. Ndërkohë që vendin e tij e kishte zënë një flamur i dytë i dhënë nga Xhemil Vlora.

Sipas deklaratës së tij: "Flamuri i parë, i z. Eqerem bej Vlorës, dhuartë e Don Gjini Aladro Kastriotit, ishte prej pëlthure leshe, me shkabën me dy krerë të snejtur me leshtë të zi në mes. Shkaba kishte krahët përgjysmë të shpallur, për së gjati trupit dhe drejtimin i sajë që krah për krah me drejtimin e shtizës, siç është edhe sot në të gjithë flamurët. Flamuri i dytë, i z. Xhemil bej Vlora, që zu vendin e të parit në grillat e dritares, që edhe ky prej leshe, sadopak i vogël me shkabën me dy krerë e kishte kokëngulmazi kthyer drejtë shtizës". Po ashtu Eqerem Vlora shpesh në flamurin e tij në vitin 1914 e kishte marrë Avni Delvina. Por flamuri ishte djegur nga vori-oeprrotët.

Ndërkohë po në vitin 1935 vetë Xhemil Vlora kishte deklaruar se

ishite ai që kishte dhënë dy flamur që i kishte nga Don Gjini Aladro Kastrioti, të dy prej leshe, i pari 50 cm X 70 cm dhe i dyti 70 cm X 1.20 cm, pa thekë dhe pa kordonë. "Flamuri i parë, më i vogël, paska qenë ai që shtolli vetë Ismail Qemali, për herë të parë në hekurat e parmakëve të njëjës prej dritareve bri ballkonit dhe pak më vonë të ngritur mbi shtizë në

Ethem i tregon se flamuri ishte marrë nga shtëpia e Xhemil Vlorës. "Pëlthura e flamuri ishte i leshtë dhe shkaba e stampuar. Nuk mban mend në ka pasur thekë apo kordonë. Më përafërsi përmasat e tij ishin 50 cm me 80 cm. Por në dallim nga dy kushërinjtë e tij, ai ishte i mendimit se flamuri nuk ishte zhdukur por se ndodhej i ruajtur në Shqipëri, ndër duar, që do të kujtohen ndofta ndonjë ditë t'ia falin Muzeut Kombëtar".

3. Varianti i tretë ka si protagonistin njërin nga firmëtarët e Aktit të Pavarësisë, Spiridon Ilon, mërgimtar në Bukuresht. Sipas kujtimeve që Spiridon Iloja i kish-

biseduan gjatë në hotel Kontinental, duke marrë të gjitha masat e duhura për ta kurorëzuar me sukses. Në Vlorë Spiridoni qëndroi në shtëpinë e Marigo Pozios që ishte vajza e tezes së tij. Atë natë ajo i kishte vënë thekët flamurit. Pasi e valëviti Ismail Qemali, unë e mbërtheva me sqepar në parmak, shprehej Iloja. Ndërkohë që në vitin 1920, kohë kur Spiridon Iloja kthehet nga Amerika boton një kartolinë me flamurin e kuq me shqiponjën dykrenore dhe me driturën: Kujtim për ditën e lirisë q'u ngrit Flamuri në Vlorë, 28 nëntor 1912.

Intensiteti i kërkimeve për flamurin shtohet në mes të viteve 30.



Eqerem Bej Vlora



Spiridon Ilo

ballkon. Flamuri i dytë, më i madhi i ngjitur mbi shtizë u ngrit më pas në portën e shtëpisë së Xhemil Vlorës. Këtë flamur të dytë të portës, e paska marrë Avni Delvina, të cilit ia kanë rrëmbyer andartët e Epirit".

Në vitin 1936 djali i I. Qemalit,

të dhënë të birit, Vangjos grupi i atdhetarëve që u nis nga Rumania për shpalljen e Pavarësisë kishte marrë me vete edhe flamurin. Edhe logjika e pranon që ata nuk do të niseshin për të ngritur flamurin pa e pasur atë me vete. Sipas Vangjo Ilos, ata kishin

Spikat këtu puna e çmuar e bejratis Sotir Kolea, drejtor i Muzeut dhe Bibliotekës Kombëtare që nga viti 1928. Ai u përpoq shumë për gjetjen e flamurit dhe ekspozimin e tij në stendat e Muzeut Kombëtar. Por puna rezultoi e vështirë. Sikurse shprehej ai

vetë "i kam hyrë një rruge nga e cila nuk po di të dal".

Në kuadër të kësaj pune ministri i Arsimit Ivanaj, bëri protagonist të historisë së flamurit të Pavarësisë edhe Lef Nosit. Më 18 dhjetor të vitit 1934 ministri i Arsimit me ndërmjetësimin e Inspektorisë së Arsimit të Elbasanit i kërkonte Nosit të përshkruante hollësisht flamurin e ngritur më 28 nëntor 1912. Në përgjigjen e tij të shpejtë pas dy ditësh, Lef Nosi bënte me dije se flamuri që ishte ngritur në Vlorë ditën e pavarësisë ishte prej stofi të mëndafshhtë, që në tregti quhej atlas, në ngjyrë të utullës, "pak ma e çelët se mostra mbyllë këtu", shprehej Nosi. "Shqiponja është si e sotmja vazhdonë ai, me dy krena e me dy krahë të ndemë, premë nga një copë sateni të zi dhe ngjitet mbi flamur". Këtë punë e kishte bërë zonia Marigo Pozio në shtëpinë e saj. "Kur flamuri ishte duke u qepur delegatët që kujdeseshin për këtë punë, shkollin e vinin në shtëpinë e zonjës për me e shty qit ta mbaronin pa vonesë, për të shpejtuar shpalljen që pritej me padurim". Pas shpalljes së pavarësisë, flamuri i ishte dorëzuar Xhemil Vlorës, me kërkesë të tij për ta ruajtur, mbasi shpallja e independencës ishte bërë në selamllëkun e tij, banesë në të cilën qeveria ndenji disa kohë.

Në letërën e falënderimit të ministrit Ivanaj dërguar Lef Nosit, kërkoheshin hollësi të mëtejshme si p.sh: A kishte flamuri thekë? Nëse po ishin ato të mëndafshhtë apo të leshtë? Po ashtu kërkoheshin edhe përmasat e flamurit. Ashtu si edhe në letërën e parë, përgjigjia mbërriti shumë shpejt. Por Nosi nuk kujton të nëse flamuri kishte pasur thekë apo kravatë. Sa i përket përmasave me hamendje, ato mund të kishin qenë 1.60 me 2m, pra një flamur i madh dhe jo i vogël.

Po në fund të dhjetorit, në lidhje me flamurin Lef Nosit iu kërkua mendimi edhe nga Ethem Haxhiademi. Në një letër dërguar Nosit nga Gjirokastra më 24 dhjetor ai krahas konstatimit të drejtë se mbi këtë çështje kishte dijeni të plotë Lef Nosi, i cili jo vetëm që kishte qenë në Vlorë kur ishte ngritur flamuri, por edhe dallohet si njeri me ndjeshmëri të lartë ndaj këtyre "gjanave", ai evidentonte vlerën e deklaratës së Nosit për të ndriçuar opinionin mbi një gjë kaq interesante dhe me vlerë kombëtare, siç edhe konsiderohej çështja e flamurit të pavarësisë.

Në përfundim mund të themi se mungesa e burimeve primare siç janë fotot apo dokumentet e shkruara gjatë atyre ditëve, e bën të vështirë njohjen e veçorive fizike të flamurit të Pavarësisë, kam parasysh këtu përmasat, materialin, punimin e shqiponjës, etj. Kjo çon në ekzistencën e shumë varianteve, çka e bën më të amullt situatën dhe na sjell vështirë në përcaktimin e tij. Megjithatë, duke ditur se Lef Nosi përgjithësisht njihje si njeri me integritet, që kishte sensin e historisë dhe njëjtë vlerën e dokumentit, varianti i parë që identifikohet me emrin e Marigo Pozios, mund të thuhet se, për shkallën momentale të njohjes, siguron një pikë të fortë mbështetjeje.

TRADITA | VLERA

SAN GIORGIO LUCANO

Shën Pali Shqiptar dhe kërcimi i drapërit

Pietro Abitante

Arbëreshët koronë nuk do të pranoni kurrë të punon tokat e "lëtinj"-ve duke iu nënshtruar, më pas, kushteve të vendosura nga Shteti i Noja-s...

Po San Giorgio Lucano është një fshat me origjinë shqiptare, apo jo? Nëse dëgjon sanxhorxhezët duket se jo: "Në lidhje me themelimin e San Giorgio Lucano dhe emrin e tij, disa mendojnë se fshati është themeluar nga shqiptarët dhe se emri original ishte Minullo. Nuk është e vërtetë!", duket se thotë, gati i mërzitur, Benito Carlomagno në tekstin e tij "San Giorgio Lucano: historia, ambienti dhe folklori" (Ed. Montemurro, Matera, 1962, pag. 13). Në numrin e Rilindasit të 26 gushtit në lidhje me origjinën shqiptare të San Giorgio Lucano, duke iu referuar një të dhënë bibliografike të T. Pace që, duke shkruar për fshatrat shqiptare të Bazilikatës, sjell një shënim të G. Stigliano "... Gjithmonë në 1534 Roberto Sanseverino, princ i Salerno-s, dërgoi një grup koronësh në Noja që themeluan Shën Palin Shqiptar, Shën Kostandinin Shqiptar dhe San Giorgio Lucano..." , shkruhet se e vetmja e dhënë ishte ajo gjuhësore e emërimit "Mënuj" me të cilin vetëm arbëreshët kanë thirrur gjithmonë San Giorgio-n. Domethënia e fjalës kuptohet lehtë nga e njëjta idiomë sanxhoveze me të cilën përcaktohen bajamet: "minull" vjen nga arbërishtja "mindulla". Ndoshta zona ku ndodhet fshati ishte e pasur me bajame. Ku i dihet?! Është e vërtetë gjithsesi që kapituajt për San Giorgio-n kanë një datë të saktë: 8 gusht 1607: asnjë objeksion ndaj Benito Carlomagno. Por çfarë ka ndodhur me ata shqiptarë në periudhën që shkon nga 1534 deri më 1607, nëse shënimin i Stigliano-s është i besueshëm? G. Stigliano shkruan: "Rreth vitit 1534, një numër i mirë shqiptarë të larguar nga qyteti i Koronës me ndihmën e Perandorit Carlo V, ishin vendosur në "Shtetin e Noja-s" duke themeluar Bashkitë e Shën Kostandinin dhe të Casalnuovo (sot Shën Pali Shqiptar). Në lartësi të lumit Sarmento dhe Fiumarella, ekzistonte një familje çobanësh problematikë jo për nga natyra por për shkak të kushteve ambientale ku ishin të detyruar të jetonin: në fakt nuk duroheshin shumë nga vendosja e mbaheshin larg klerikët latinë për shkak të diversitetit të ritualit fetar ndonëse liria për ta ushtruar ishte vendosur nga Papa. Edhe peshkopët e kohës nuk kishin konsideratë të mirë shqiptarët të cilët i quanin "njerëz fshatarë" (San Giorgio Lucano, nga themelimi tek autonomia komunale, Biblioteca Provinciale e Materas).

Si shkruan tamam gjërat nuk është shumë e qartë. Por një dëbim i tyre, jo si "rëmuja-hinj" dhe më dinjtoz, del në pah nga konsiderata se shqiptarë koronë me Carlo V kishin pasur privilegje fiskale pasi kishin luftuar dhe mbrojtuar krishtërimin kundër turqve dhe Mbretit i Napoli i kishte rekomanduar me markezi i Villafranca për një vendqendrim të përshtatshëm për rangun dhe gjestet e tyre. Kur mbërritën në territorin që u ishin caktuar u detyruan të përshtatën me zona të ashpër dhe me fisnikëri të tyre nuk dinin më ç'të bënin, në një periudhë kur uria dhe epidemitë

ishin prezente kudo: ndaj, u detyruan të vdhnin e grabitnin ("kur shikon arbëreshin dhe ujkun, qëllon më parë ndaj arbëreshit e më pas ujkut", thonë ende sot vendasit) dhe kur më 1607 peshkopi i Venosa-s, me vendim të Kurias, urdhëroi që Maschito të digjej sepse banohej nga shqiptarë "famëkeq", Fabrizio Pignatelli nga Noja, i mbështetur nga peshkopët e tjerë të ritualit latin që nuk duronin dot klerikët e ritualit grek dhe i bezdisur nga sjellja

e atyre çobanëve, i largoi nga San Giorgio të cilin ia dha disa të ardhurve nga Trebisacce, Castelsaraceno dhe Viggianello për të themeluar një fshat që mori emrin e vendit. Koncesioni u dha më 8 mars 1607, datë që shënon themelimin zyrtar të San Giorgio Lucano. (Stigliani, si më sipër, faqe 57-58). Por zotëria e Noja-s e bën me disa kushte shumë strikte që mund të shpjegojnë përsë "rëmuja-hinjte" shqiptarë u detyruan të largoheshin: vendos

taksa, ndalime, dhe pastrime të territorit dhe sidomos pamundësinë për të përfutur territorin që San Giorgio kishte. Dihet që arbëreshët ishin shërbyes besnikë "në artin e armëve" por kurrë nuk do të kishin pranuar të ishin "shërbëtorë" në tokë të tjetrit. Si provë e këtij supozimi personal mund të ofrojë një qartësim rituali i Kërcimit të Drapërit, prezent jo vetëm në traditën e Shën Palit Shqiptar me rastin e festës së Shën Krokut, por, nën emrin Loja e Drapërit, festohet çdo vit në San Giorgio për të rievokuar, në përfundim të stinës së korjes, shfrytëzimin dhe shtypjen e padronëve. Ritualin zhvillohet në perëndim, kur gratë lidhin duajt duke grumbulluar "dorazë"-t e fundit. Pamundësia për të qenë padronë të tokës së bonifikuar dhe punuar prej tyre është tema qëndrore e kësaj loje, pantomimë e ak-

Mënujli, Shën Palji e Dënxa Drapërit

Po Mënujli i ka orixhinet albëreshë, apo jo? Thënkja munuljotëtë s'është ashtu: "Dica thonë se Mënujlin e fundartin albëreshët e dhe ia dhanë emërin. S'është vërtetë!" shkruan prej Markesit të Villafranca, të zëjn vend në lloke ashtu si i ngjasin pse kishin bërë guerrën kundër Turqit e difënditur Krishtin e e kishin të drejtën për privilegje. Po një herë arrivarë të vendit të dhënura kjenë shtrënguar në prenje, kallanga e hërsa të shkretë, me një mot karestie kur gjindja vdisni uri: ashtu s'panë si t'ë bëjn ndryshe e u dhanë tue kalluar për të rrojn (Quann' vid' u bërësh e u lup, spar' prim' u bërësh e po' lup' thonë adhe ljetinj) e kur në 1607 veskovi i Venozës ordinarti të digjin Maskitin, pse atashin kisherë pljot me turp, Fabrizio Pignatelli, zoti i Nojës muar kurazh e i nxuar albëreshët ka Mënujli (... infastidito dal comportamento di quei pastori, li scaccio dal casale di "San Giorgio" che cedette ad alcuni coloni provenienti da Trebisacce, Castelsaraceno e Viggianello per fondarvi un paese che prese il nome del sito. La concessione venne erogata l'8 marzo 1607, data che segna la fondazione ufficiale di San Giorgio Lucano". (G. Stigliani come sopra pagg 57,58) po buljari i Nojës ia dha Mënujlin kolonëve me disa kondiciona shumë të rëndat: për të hijn Mënujli, pan të bonifikarin pandanin, kishin daxe të paguain e mësegithë s'mënd të bëhëshin patron të dheravet për të bjellur që ata vet shërbein: Mënujli ish' i vetëm katund i Valsarmendit që kish' dhera të bukur! Nani, dihet se ata albëreshë ishin "shërbëtorë" në "larte delle armi" po maj e poj maj mënd të aqëtarin të shërbein dherat e të tjerëvet. Një provë, për këtë, mënd të jetë Joku Draprit , zakoni i Menuljit edhe i Shën Paljit i Albëreshëve. Në Mënujli ky zakoni bëhet kur rriten të korrat për të sillen tek mendja s'frutamentin e shtipjen e patronit. Riti bëhet me të uljuri e diellit, kur gratë mbjedhën të ljujtëmet dorazë e i bënë dhumatë. "Mos të jeshë patron të dheu që ti bonifikarte e vet e shërben" është kreqmotivi i këtij zakoni, pan mënd të fëtitëq së të korravet. "Nel loro animo restava il desiderio della ricchezza proibita. I coloni sognano di spogliare il signore della sua ricchezza, di abbassarlo una volta al proprio livello, di dominarlo almeno simboli-

camente" komentat Anna Maria Bianchi e Menuljit tek deplandi i Prologo's. Domethënë se burrat bëjnë dhja sikur nëk kuarnjën, po sikur duanë t'ë zenë çjapin (patruni i dheu): "un vecchio contadino fa da capro: due mazzetti di spighe tenuti fra le labbra, una pelle di capro legata alla schiena, i falchetti impugnati all'altezza del capo a mo' di corna....Burra mimamjën të korrat me kar-ranuxa e bëjnë batalja me drapribn. Il m-etera, spiegar E. De Martino në "La messe del dolore", era avvertito con un colpo uccidere di cui si portava il rimorso. Il bisogno perciò di mascherare la mietitura con la pantomima del Gioco della Falce; per raccogliere il grano, figlio della Terra, bisogna ucciderlo, con offesa alla Madre(dheu)". Riti esorcixar, te munuljotëtë, frustracionën i kolonëve që rifondartin katundin në 8 gushtit 1607 e të ciljet kishin aqëtarur kondicionat të shtringuara e feudatarit të Nojës, kurse me Shën Palj Dënxa e Draprit bëhet vetëm me dy burra të veshur me drapërit, vandilje e glijstëtja e bëjnë dhja sikur njeri (koloni) do te ia kalonj dhumatin të jetrit (patrunit). Po s'është vetëm ky zakon që mënd xhustifikar se kjen albëreshët që e fondarti të parin herë Mënujlin. Dhumëni i Shën Paljit, e mbllin atë i Çërtözës, e arivon njera dy kilometre afër Mënujlit: voshku i Maradhözës e dherat rrorro janë adhe proprietata alb-jbëreshë si duket ka emërat e fëmijavet që i pan e që i kanë adhe, si Blumetti, Calluori e Camodeca e kapiret dhe ka emërat që çërtuzjanët i vunë atyre zonave: "a masserie du 'bresh, a masserie i Calluor, i grutt' di 'briesh që ndodhën atje afër ljuimit Sudhan. Mënd të jetë se tek këto gruta, pas që iktin ka Mënujli u kanë furqisur, të shkretë, me gjithë kafshë tue kërkuar gitudanxën Shën Paljit e dhe Farnetës e Kastërnexhit, që ndatë mot ishin me Bazilikatën. Prandaj mënd të hipotizaret se katundi i vjetër i Mënujlit kije më vërtet i abitarur ka albëreshët koronë që në 1534 njera kur kjen shtrënguar e ljetjshin: ata s'dishtin të shërbein dherat e ljetinjvet e mësegithë me ato kondiciona, me të ciljat, në 8 gushtit 1607, u qikartin Kolonët e Trebisacës, Castelsaraceno e Viggianello e rifondartin Mënujlin. Dënxa e Draprit docet.

Pietro Abitante





sonit të korrrës. "Në shpirtin e tyre mbetet dëshira e pasurisë së ndaluar. Të ardhurit ëndërronin zhvishnin zotërinë nga pasuria e tij, ta ulnin një herë në nivelin e tyre, të zbusnin të paktën simbolikisht", komenton Anna Maria Bianchi në broshurat e pro loco's së San Giorgio's. Korrsëit, pra, sillen sikur aksioni i kryer prej tyre të mos ishte korrrja, por një gjueti ndaj dërrit (padronit): "një fshatar i vjetër bën çjapin: dy tufa veshësh gruri të mbajtura mes buzëve, një lëkurë çjapi të lidhur në kurriz, drapinj të në duar në lartësinë e kokës në formë brirësh... korrsëit mimmojnë korrrjen nën ritmin e gajdes dhe kryejnë figura me drapërin. "Korrrja, shpjegon E. De Martino në "La messe del dolore", ndjehej si një vrasje fajtoze për të cilën mbahej peng. Nevoja, pra, për të maskuar korrrjen me pantomimën e Lojës së Drapërit: për të grumbulluar grurin, bir i Tokës, duhet të vrasësh, dyke fyer Nënë (Tokën). Ritualu largon, te sanxhorxhezët, simbolikisht pendimin atavik të të ardhurve të së largës "8 gusht 1607" që pranuan kushtet e rënda të vendosura nga zotëria i Noja's, ndërsa në Shën Palin Shqiptar Kërcimi i Drapërit përbëhet nga dy personazhe që, me drapinj në duar, mimmojnë luftën mes padronit të tokës që mbron grurin e tij dhe të ardhurit që tenton t'ia marrë. Nuk është vetëm ky ritualitet i përbashkët, me variante të ndryshme festohet edhe në fshatra të tjerë lukanë, që të çon të justifikosh mundësinë e themelimit nga ana e shqiptarëve të San Giorgio's. Të mbështetur nga referimet storiografike të cituara më sipër, mund të mbrohet edhe më tej kjo tezë duke vëzhguar me kujdes territorin historik dhe atë aktual të Shën Palit Shqiptar. Ai arrin në rreth dy km në linjë ajrore nga San Giorgio. Pylli bashkiak i Madarosa's, burim i konsiderueshëm kullote, irretuar nga terrene në pronësi arbëreshëshe dhe onomastika janë provë e preksime me emra familjes të vendosura si Blumetti (bulmet), Calluori (kaluar) e Camodeca ("dhjetëgra", nga greqishtja) familje historike nga Shën Pali, me emërtime në idiomën autoktone lagjesh si "a masserie du 'bresh" (ferma e arbëreshit), "a masserie 'i Calluor" (Kaluar), "i grutt' d'i 'briesh" (shpellat e shqiptarëve) nga të cilat mbeten ende sot 3 grupe: një nga 17 elementë banimi Këpucë (?), një tjetër me 11 (Mikuc) dhe i fundit me 8. Eshhtë e mundur që në këto shpella, pasi largohesh nga San Giorgio, të kenë gjetur strehë për vete e për kafshët e tyre duke kërkuar më pas të jetojnë kryesisht në Shën Palin Shqiptar dhe me gjasë edhe në Farneta e Castoregio, (këto dy të fundit dikur i përkisnin territorit lukan) e duke mos braktisur kurrë territoret që kishin. Ndaj, mund të hipotezohet se vendi primar i San Giorgio's të ketë qenë banuar efektivisht nga koronë të vitit 1534 deri në momentin që u detyruan të largoheshin: arbëreshët koronë nuk do të kishin pranuar kurrë të punonin tokat e "lëtinj"-ve (italianët autoktonë), duke i nënshtruar, më pas, atyre kushteve të vendosura nga Shteti i Noja's, ndaj të cilave u përkulën të ardhurit nga Trebisace, Castelsaraceno dhe Vignianello, duke u vendosur e duke marrë kontrollin e territoreve. Siç tregon Loja e Drapërit!

SKULPTURA | DEFORMIMI

ADEM JASHARI

Monumenti në Maqedoni që shpërftyron heroin

Është realizuar nga një mësues i ciklit të ulët në Tetovë. Thirrja: Të hiqet sa më parë dhe një figurë skulpturore apo imazh dinjitoz t'i kushtohet Adem Jasharit në Radushë të Maqedonisë

Suzana Varvarica Kuka

Pse drejt e mori do të vazhdojnë të ndodhin me ne shqiptarët kaq bëma, prej të cilave, të vjen të pëshpëllorsh dhe të ngatërrohesh më së pari me identitetin tonë në histori dhe, mandej me veten në kohësinë kulturore të ditëve tona? Dhe kur lidhet kjo ofshamë me krijimtarinë shqiptare monumentale të shekullit XXI, si dhe drejtëpërdrejtë me imazhin e turpshëm tredimensional, kush-tuar Adem Jasharit në Radushë të Maqedonisë, atëherë, ajo ofshama individuale, duhet të kthehet në një britmë qytetare shqiptare, që t'i kujtojë atij që e ka kryer atë imazh, të shkojë e ta shkëlqë menjëherë e le të mendojë se e ka turpshëm kombin e shqiptarëve në këtë 100 vjetor.Mendoj se ky është një apel për politikanët shqiptarë të Maqedonisë, të cilët kanë pranuar që ky pseudo monument të ngrihet në një vend ku banojnë shqiptarë. Për të ngritur një monument, vendin dhe kohën kur vendosim ta ndërtojmë, duhet të mendohemi shumë mirë. Ata duhet të jenë të një cilësie të lartë dhe pa asnjë ekuivok të dyshuar historik dhe artistik. A e shohin politikanët dhe artistët shqiptarë të Maqedonisë se çfarë po bëjnë politika dhe administrimi artistik maqedonas, për të memorizuar në Shkup, figurat dhe ngjarjet e ndodhura në periudha të ndryshme të historisë në atë tokë? I kërkoj falje lexuesit që kaq shpesh po e ndjen së brendshmi fjalën duhet, por në të këtillat raste është e domosdoshme. Ata, pra njerëzit me kollare, së pari duhet të turpohen për lejinim e genes së atij monumenti dhe, së dyti më lejoni t'i bëj me dije se: të gjithë kombasit tanë, kudo që ndodhen, e dinë masëmiri se burri shqiptar i Kosovës, Adem Jashari ishte një burrë shtatdrejhtë dhe trupi i tij paraqiste madhësi. Figura e tij do të na lidhë përherë me patriotizmin e ri shqiptar të shekullit XXI, ku vetëm një atdhe i drejtuar në liri i jep liri kombaseve të tij. Por çfarë ka bërë i mjeri njeri "artisti" me figurën e Adem Jasharit në Radushë? Në mënyrë të natyrshe figura e Adem Jasharit do të frymëzonte çdo qeveritar apo politikan të lartë shqiptar, që të bëhej iniciator i ngritjes së një monumenti dinjitoz, për këtë figurë luftarake, por politika e shqiptarëve të Maqedonisë duhet shumë shpejt të tregojë se nuk ka sesi të kënaqet me një monument bastard. Ju lutem emër të artit dhe të asaj që dinë të bëjnë artistët profesionistë shqiptarë hiqeni atë krahurë mjetesht luftarake! Ai ndjell vetëm urrejtje, trishtim dhe keqardhje. Kushtoi një monument siç i ka hije, nëse pretendoni se e respektoni, Adem Jasharin. Ju, që e in-aguruar dhe ai njeri anonim e mjeran që e ka kryer atë zallamahi figurative, do të jeni gjithmonë të gjykuar nga një pjesë e denjë e shoqërisë shqiptare. Ofshama ime kaq e shpejtë ka disa arsye-time. Le të mbetemi tek arsyetimi i parë. Për ne shqiptarët e Shqipërisë, që kaluam për 50 vite të mbyllur në darrë që na mbërtheu e na mbajti bashkë në një shoqëri kolektive komuniste, ishte shumë e thjeshtë dhe madje shumë normale të ndërtonim monumente të madhësive "grotesko-kolosal", për udhëheqësit komunistë. Pas '90 populli shqiptar i Shqipërisë kundërshtar i komunizmit, hakmarrjen ndaj tyre e mori duke iu hedhur në kurriz modeleve prej bronzi dhe i zvarriti në rrugë, ashtu siç dikur komunistët zvarritnin armiqtë e popullit. Dhe në atë kohë që shqiptarët e Shqipërisë ngrinin monumentet e realizmit socialist, shqiptarët e Kosovës, Malit të Zi dhe Maqedonisë bënin art, të cilin po e cilësoj të lirë, pasi kahte drejt imazheve moderne: ishte krejt individual, pasi nuk bëhej fjalë që artisti të parimohet nga ambicia e politikës, për të sjellë imazhet e veta në trajtësa piktorike apo skulpturore. Ata bënin një art plot trajta dhe shprehje, qasja e të cilave afrohej

dukshëm me drejtimet artistike të provuara të shekullit XX. Madje arti i shqiptarëve të trojeve shqiptare jashtë shtetit shqiptar gjenerohej nga platformat e shkollës serbo-kroate të artit. Sot, pa asnjë mëdysheje duhet thënë se ajo i mbante krejt të hapura dritaret e saj, ku informacioni i imazheve të shumëllojta të përvojave perëndimore dhe të pasurisë lindore ndihmonin në rritjen individuale të artistit, por edhe në krijimin e fizionomisë artistike të kombësive të ish Jugosllavisë. E natyrisht kjo atmosferë ndikoi edhe tek artistët me kombësi shqiptare në Kosovë, Mal të Zi dhe Maqedoni, të cilët gjen emrat e të nderuarve Muslim Mulliqi, Agim Cavdarbasha, Gjelosh Gjoka, Xhevdet Xhafa e tjerë. Pas viteve '90, kur artistët shqiptar hoqën dorë prej realizmit socialist dhe iu nënshtruan rrugës normale të artit me pikësynim kryesor gllirimin e plotë nga dogmat e metodës, në Kosovë, pasi ajo fitoi pavarësinë e saj, ndodhi një përmbysje konceptuale e skulpturës së zhvilluar deri aso kohë. Ajo iu drejtua realizmit socialist. Buxheti dhe financa e parave të grumbulluara nga donatorë të prirur me të drejtë legitime, për të ndërtaur monumentet e heronjve të rënë në luftë, të cilët ishin bashkëqytetarë apo dhe bashkëluftëtarë në të, u dërguan drejt skulptorëve shqiptarë të Shqipërisë, të cilët



pasi i kryen ato monumente, i dhanë frymën e realizmit socialist. Shumë prej këtyre monumenteve, fatkeqësisht, kanë atë pamje të skulpturës shqiptare të viteve '70-'80. Mjedisi artistik skulpturor në Kosovë dhe Maqedoni u anashkalua, nuk u respektuan konkurset kombëtare, nuk u respektuan aftësitë e artistëve më të mirë të vendeve përkatëse dhe realizimi i tyre i'u la në dorë, krejtësisht, rastësisë së imazhit revolucionar, të krijuar nga skulptorë të Shqipërisë apo skulptorëve amatorë shqiptarë të Kosovës, të cilët do t'i quaja pa asnjë dyshim, të papërgjegjshëm, si kundërdrejt publikut dhe si kundërdrejt artit. Këta monumente u bënë shkak i devijimit të edukimit të shijes së publikut me skulpturën më të mirë evropiane figurative, që ka treguar me shembuj se shtatorët kush-tuar personaliteteve të kohëve të ndryshme dhe të profesioneve të ndryshme, janë kryevepra botërore, të artit klasik, realist e impresionist në skulpturë. Kjo situatë polli dhe shtatorin e shëmtuar të politikës amerikane më të dashur të Kosovës, Bill Klintonit, në Prishtinë. Kjo situatë polli dhe mjedisin e shëmtuar të skulpturës së shpërftyruar të të madhit Adem Jashari në Radushë të Maqedonisë. Të dy monumentet nuk mund të quhen të tilla, janë skulptura, të cilat nuk mund të quhen të tilla. Për mua janë grumbuj volumesh metalike pa bosht artistik, janë amatorizma të theksuara, janë keqinterpretime të pamjeve të jashtme dhe të psikologjisë së brendshme të dy personaliteteve. Pamja e tyre na fyen si komb, fyen heronjtë, fyen arrijtet më pozitive të artit në trojet shqiptare, fyen artistët e rinj më në zë shqiptarë, që ekspozojnë në muze të njohura të shek. XXI e që njihen sot nënderkombëtarisht, fyen diplomacinë dhe politikën mendimtare evropiane perëndimore shqiptare, me të cilën shqiptarët dëshirojnë të aderojnë në Europë. Më lejoni më së fundmi t'iu vë në dijeni edhe më një fakt të dobishëm. Kërkova nga burime studimore të gjega emrin e "skulptorit" të grumbullit metalik në Radushë dhe askush nuk e dinte dhe askush nuk ma tha qartë. Madje më së fundmi më shkruajtën një mesazh se mund të jetë vepër e një Selam Mustafi, mësues vizatimi, shkollave të ciklit të ulët nëTetovë. Kjo tregon se ai grumbull, i asaj pamjeje, duhet të hiqet sa më parë dhe një figurë skulpturore apo imazh dinjitoz artistik t'i kushtohet Adem Jasharit në Radushë të Maqedonisë.

JETA | VEPRA

MUSTAFA MERLIKA KRUIJA

Portreti i një atdhetari dhe studiuesi

Nga Aleksandër Meksi

Mustafa Kruja hyri në historinë shqiptare si një emër i vyer për të mbetur në të pavarësisht ndodhjeve të kohës. Jeta e tij është intensive me veprimtari atdhetare e politike e njëherazi dhe si studiuesi e pasionuar...

Mustafa Kruja hyri në historinë shqiptare si një emër i vyer për të mbetur në të pavarësisht ndodhjeve të kohës. Ai shquhet si atdhetar qysh në rini në vitet e shkollës, merr pjesë si drejtues në Kryengritjen e Madhe shqiptare të vitit 1912 që parapriu Pavarësinë, përfaqëson Krujën në Vlorë. Jeta e tij është intensive me veprimtari atdhetare e politike e njëherazi dhe si studiuesi e pasionuar.

Mustafa Merlika Kruja lindi më 15 mars 1887 në Krujë. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndër- sa shkollën e mesme e kreu në Janinë, në gjimnazin turk të atyshëm ku, në përfundim të studimeve, u klasifikua i pari.

Më 1910, pasi fitoi konkursin e pranimit, u regjistrua në universitetin Mykijje të Stambollit ku përfundoi studimet për shkencat politike dhe administrative me rezultate të shkëlqyera.

1911, filloi punën si mësues në gjimnazin e Durrësit prej nga largohet për veprimtari atdhetare. Stambolli kërkon ta internojë në Irak.

Më 1912, mori pjesë aktive në Kryengritjen e madhe të shqiptarëve kundra Perandorisë Osmane dhe ishte koordinator i saj për Shqipërinë e Mesme.

28 Nëntor 1912, si delegat i Krujës, merr pjesë në Kuvendin e Vlorë në Shpalljen e Pavarësisë e Shqipërisë, firmëtar i Aktit dhe sekretar i Kuvendit, ku zgjidhet dhe anëtarë i Senatit apo Pleqësisë. Emërohet nënprefekt i Vlorës.

1913, emërohet drejtor i arsimit në Elbasan.

1914, përkrah ardhjen e Princ Widit dhe së bashku me Abdi Toptanin luan rol të dorës së parë në kundërshtimin e lëvizjes antikombëtare të Haxhi Qamilit duke e penguar që ajo të triumfojë në Krujë.

Më 1915, me urdhër të Esat Pashës arrestohet dhe dërgohet në burg, në Bari, si kundërshtar politik i tij. Pas një viti burgimi i kthehet në internim në ishullin e Favjanës.

1917, pas lirimt nga internimi vendoset në Romë ku punon si kryeredaktor i revistës politiko-letrare "Kuvendi".

1918, kthehet në atdhe dhe menjëherë hidhet në veprimtari politike. Në Durrës, më 25 dhjetor, merr pjesë në qeverinë e Turhan Pashës, si ministër i Postë - Telegrafës.

1921, në zgjedhjet parlamentare për Këshillin Kombëtar, zgjidhet deputet i Kosovës.

1922, merr pjesë në kryengritjen e Elez Isufit për rrezimin e qeverisë. Me dështimin e saj arratiset në Jugosllavi.

Kthehet më 1924 dhe merr pjesë në revolucionin e Qershorit. Nga qeveria e Fan Nolit emërohet prefekt i Shkodrës. Pas rrezimit të Qeverisë së Nolit, si shumë politikanë të tjerë kundërshtarë politikë të Ahmet Zogut, arratiset në Itali. Por kohën më të gjatë e kaloi në Zvicër.

Pas pushtimit Italian kthehet në Shqipëri.



Ai u kthye në një mërgimtar duke lëvizur nga Austria në Itali, në Zvicër, më pas në Egjipt e Francë, pranë kundërshtarit të dikurshëm, Ahmet Zogut, për ta mbyllur jetën në SHBA, në qytetin Niagara Falls

Në foto: Mustafa Merlika Kruja

Si studiues, drejton Institutin e Studimeve Shqiptare dhe nuk merr pjesë në jetën politike.

Duke kuptuar rrezikun e madh që i vinte Shqipërisë nga komunizmi dhe sllavët, në fund të vitit 1941 pranoi të bëhej kryeministër, post që e mbajti për 13 muaj. Dorëheqja e tij që e përvokueshme sepse qeveria italiane nuk ju përmbajti kushteve që u formuluan kur ai pranoi postin e lartë.

1944, shkoi në Vjenë, për t'iu ndodhur djalit më të vogël pranë, në momentet e fundit të jetës. Ndërkohë në Shqipëri triumfuan komunistët dhe Mustafa Kruja nuk u kthye më kurrë në atdhe.

Ai u kthye në një mërgimtar duke lëvizur nga Austria në Itali, në Zvicër, më pas në Egjipt e Francë, pranë kundërshtarit të dikurshëm, Ahmet Zogut, për ta mbyllur jetën në SHBA, në qytetin Niagara Falls, duke u bashkuar me djalin tjetër dhe me motrën. Amerika, e kishte pranuar këtë "armik" qysh me kërkesën e parë për bashkim familjar dhe e kishte bërë qytetar të saj.

Vdiq më 27 dhjetor 1958, në moshën 71 vjeçare, në SHBA.

Me gjithë vështirësitë e jetës nën diktaturë, përndjekjet dhe vrasjet, burgosjet dhe internimet, pasardhësit e Mustafa Krujës u kthy-

en në liri pas vitit '90 kur Shqipëria u çlirua nga zgjedha e komunistëve në shërbim të të huajve, më e keqja, më çnjerëzoria, më kriminaleja dhe më gjakatarja, që një popull shqiptar gjatë gjithë historisë. Mustafa Kruja u përfshi në Kryengritjet shqiptare dhe në krijimin e shtetit të parë shqiptar, duke mos ardhur nga rangjet e larta të zyrtarëve të Perandorisë Turke, të mbetur pa punë pas shembjes së saj, as edhe nga shtresat e feudalëve, që ishin me këdo po të mos t'u prekeshin pronat. Ai vinte nga shtresa e mesme e shkolluar dhe dallohej për formimin dhe për aftësitë intelektuale. Nga bashkëkohësit njihej si njeri i ndershëm, atdhetar e antikomunist i flakët, por njëherazi, dhe si intelektual dhe guhëtar i dorës së parë, me kontribute të spikatura në këto fusha. Mustafa Merlika Kruja bën pjesë në atë grup jo të shumtë shtetëtarësh shqiptar të gjysmës së parë të shek. XX-të si Faik Konica, Ekrem Vlora, Mehdi Frashëri, Sejfi Vllamasi, Lumo Skëndo, Teki Selenica, Dhimitër Beratti e të tjerë, e madje më tepër se kushdo, që me penën e tyre dhe vërtetësinë e dëshmi- të dokumentuara, ndihmojnë për të njohur historinë e trazuar të Shqipërisë dhe shqiptarëve në periudhën nga Pavarësia deri në Luftën e Dytë Botërore. Studimet e tij, ato që munda t'i ruante familja, letërkëmbimi gjatë kohës që

ishite në emigracion, si dhe ato dorëshkrime historike që mori me vete apo shkroi kur ishte në mërgim, po botohen nga të afërmit e tij, duke u vlerësuar e ndihmuar studiuesit.

Nga pena e tij e vyer kemi kontribute si historian e për historinë tonë, në disa libra të botuara ndërkohë; por mbeten mënjane një numër shumë i madh shkriimesh, të cilët duhet të përmbledhen dhe botohen sipas fushës që i përkasin. Por ka edhe materialeve të tjera që ruhen në arkiva shtetërore dhe private.

Do të ishte me mjaft interes që të dhënat si dëshmitarë i drejtpërdrejtë i ndodhjeve historike, si një aktor i tyre, ashtu si dhe gjykimet e tij, t'i vendoste dikush në rend kronologjik, ose sipas problemeve apo ngjarjeve, që do të ishin të dobishme për lexuesin dhe historianët si një minierë e vërtetë, sepse ai është një ndër të paktët qeveritar e personalitet i historisë shqiptare që flet. Ai sigurisht do ta bënte këtë histori por vdekja e parakohshme ja mohoi.

Ky emigrant i përjetshëm, kundërshtar si i mbretërisë së Zogut, me të cilin pajtohet në Egjipt në vitin 1948, ashtu dhe i diktaturës komuniste që erdhi më pas, nuk e shkoi kohën kot në mërgim por, gërmoi nëpër arkiva dhe biblioteka, krijoi dhe punoi, në kushte të vështira jetese, ndërkohë që të dashurit e zemrës së tij lëngonin kampeve të fashistëve të kuq, punoi me përkushtim dhe pikësynime të qarta; për t'i lënë atdheut një trashëgimi të pasur. Është ndër të paktët qeveritar të këtij vendi, që dhe pas politikës, shkëlqyen në fushën e letrave edhe shkencës. Energjitë dhe kohën më të madhe ja mori Fjalori i Gjuhës Shqipe, me rreth 30 000 mijë fjalë dhe 2600 faqe (siç dëshmon Karl Gurakuqi), një vepër madhore, e pajisur me shënime edhe në aspektin etimologjik për shumicën e fjalëve, por që diktatura e zhduku "pa lënë gjurmë", ndonëse ishte bërë gati për botim qysh në vitin 1943.

Ndoshta kërkimet e ardhshme nga një brez i ri guhëtarësh të pakompleksuar nga e kaluara e të paimplikuar me të, do të flasin më me saktësi edhe për këtë. Në studimet guhësore ai jep një kontribut të gjithanshëm: për pasurinë leksikore dhe elementët e prodosidë, për strukturën morfologjike e ndërtimit sintaksore, për aspektin fonetik e fjalëformues, për etimologjinë e të dhënat dialektore, për toponiminë historike si dhe guhën e njësuar. "Prej tij sot trashëgojmë një dokumentim... të lëndës guhësore" me vlera për lëvrimin e guhës sonë, duke patur në themel parimet e tij. Ai, si rilindësit, mendonte se prej guhës mund të fitonin sfidën e qytetërimit të mendimit. Shkrimet që na ka lënë si trashëgimi janë të natyrave të ndryshme dhe vetëm një pjesë e tyre ishte botuar në periodikët e kohës brenda vendit ndër- sa më të shumtat në shtypin shqiptar të diasporës. Kjo është vetëm një pjesë e punës së tij gjysmëshkulllore. Shumë nga shkrimet dhe studimet e Mustafa Krujës presin të botohen. Ato janë pasuri kombëtare dhe kontribute në shkencën tone.

Lista e dorëshkrimeve është e gjatë por ne po rendisim ato, që me interesimin e familjarëve të tij, tashmë janë botuar:

- Antologji Historike, Elbasan 2001, shkrimet historike.

- Vezhgime Ilro-Shqiptare, përkthim i vepër së Ludvig Von Thalloczy, Shkodër 2004.- Aleksandër i Madh, Shkodër 2005;

- Fjaluer kritik i shqipes, Germat A dhe B, Tiranë 2008.

- Fjalor i Frangut të Bardhë- Tiranë 2007.
 - Kujtime voglije e rinije , Tiranë 2007.
 - Problema Gjuhe, Tiranë 2012, një përmbledhje artikujsh mbi probleme të gjuhës shqipe.
 - Shkrime Historike, Tiranë 2012.
 - Kuvend letrash me miqtë, Letërkëmbimi me Gjonmarkajt dhe Zef Nekaj, vëll. I, Tiranë 2012.

Por ka dhe ndonjë vepër në dorëshkrim që ende nuk ka parë dritën e botimit si Shqipëria përpara Konferencës së Paqes në 1919, bashkë me dokumente zyrtare të Qeverisë së Përkohshme në 1919; ne shpresojmë në botimin e shpejtë të tyre si dhe gjithëkta tjetër prej tij. Nuk është i rastësishëm edhe orientimi i punës së tij shkencore në fushat më të rëndësishme të përkatesisë kombëtare: Gjuhës dhe Historisë, ku ai është kërkues dhe studiues i vërtetë. Sepse Mustafa Merlika Kruja kishte vetëm një orientim: mbrojtja e çështjes shqiptare dhe antikomunizmi, edhe kur vendi ishte fushëbetejë e superfuqive të kohës, dhe e fqinjëve (1912-1924), dhe kur vendi ishte pjesë e Perandorisë Italiane, çka në këtë periudhë të fundit detyrohen ta pranojnë dhe italianët kur thonë se "puna e tij nuk përputhej me interesat italiane" (nga letra e F.Jacomonit drejtuar Ciano-s). Po kështu, me rëndësi është dhe letërkëmbimi me miq sepse siç vërente Ernest Koliqi "aty ku Mustafa, mandej arrin një përsosje letrare, ashtu stili epistolar. Ata qi patën fatin me pasë letra prej tij, duhet t'i ruajnë me kujdes sepse në to asht derdhur një visar i paçim i shqipes"

Korrespondenca e Mustafa Krujes është e gjerë: disa letra kanë humber, të tjera duhen kërkuar dhe mblledhur, sepse ka të dhëna të sigurta për to, por megjithatë, edhe këto përmbledhje flasin shumë. Ajo është pjesë e historisë së Shqipërisë në një kohë të trazuar që nis me ngjizjen e shtetit shqiptar më 28 nëntor të 1912 ku nuk ishte e lehtë të orientohesh. Por siç thamë zgjidhja e çështjes kombëtare dhe shmanja e rrezikut sllavo-komunist ishin terreni mbi të cilën ai punonte. Në shumë prej letrave gjejmë gjykime kritike për politikën dhe veprimet e politikaneve shqiptarë dhe këtu duhet nënvizuar se ai nuk kursen as veten. Në to ai tregon qëndrimet e tij për çështjen shqiptare. Në një letër thotë se "... ma mirë një Shqipëri në gjysmë lirie me Kosovë se sa Shqipëri pa Kosovën...", që dëshmon atdhetarizmin e tij, thelbi i qenies së tij politike dhe për çka luftonte ai, që për të si dhe për në Kosova është Shqipëri, që shumëkush nuk po e përmend më. Në letrat e tij ai bën disa herë vrojtme të sakta mbi marrëdhëniet e politikës shqiptare me atë botërore dhe shpreh mendimin se zgjidhjet e problemeve shqiptare janë vetëm në kuadër të zgjidhjes botërore, madje shpreh mendimin se Shqipëria do të jetë e lirë në kuadrin e një përmbyseje të rendit të atëhershëm botëror (vitet 50-të), që ai e mendonte Lufta e Tretë Botërore, gjykim që ishte i drejtë. Ishte përmbysa e rendit komunist botëror që i çliroi shqiptarët prej tyre. Në të vetmin shkrim ku dalin disa element të autobiografisë, në formën e një Vetëparaqitjeje, që në të vërtetë është Kërkesa që Mustafa Kruja i drejtoi autoriteteve amerikane për strehim politik më 1952, do t'i jepte përgjigje edhe pyetjes që të lind vetvetiu pas leximit të veprave Mustafa Krujen: e "Çfarë e shtyu atë që të bashkëpunonte me italianët kur njihje patriotizmi i tij". Mbas kthimit në Shqipëri nga emigracioni, kur punonte në Institutin e Studimeve, Ai refuzoi tri herë rresht propozimet italiane për të marrë pjesë në qeveri, por, më vonë, duke shikuar rrezikun që përbënte për

shqiptarët komunizmi, që sa vinte e forcohej me ndihmën e të dërguarve sllavë, si luftëtar i çështjes shqiptare -italianë e qanin ultranacionalist, dhe si antikomunist konsekuent pranoi.

Ai pranoi postin e kryeministrit me disa kushte që Jakomoni i miratoi. Kushtet ishin këto:

- Rikthimi në fuqi i vendimeve të 12 Prillit, d.m.th. abrogimi i traktateve që kishin të bënin me shkrirjen e forcave të armatosura dhe marrëdhëniet me jashtë;

- krijimin e një milicie shqiptare në varësi të Ministrit të Brendshëm;

- kthimin e flamurit kombëtar në formën e vet origjinale. Dhe këtë e bëri, siç thotë ai vetë, "si një detyrë e shenjtë patriotike...me i ndaluar vendit t'ëm katastrofën ma të madhe që mund të pësonte", e në këtë parashikim ai nuk u gabua pavarësisht rezultatit. Por prej tyre u pranua vetëm ajo që lidhej me flamurin (më 23 prill 1942). Dhe siç thotë vetë Mustafa Merlika: "Mbas një vjeti lufte të pa barabartë kundër komunizmit nga një anë dhe pengesave të italianëve e të bashkadhetarve të mij vetë, qi nga ana tjetër duhej të më përkrahëshin, vendosa me dhanë dorëheqjen". Ai u tërhoq nga politika dhe sidoqoftë u përpoq për një bashkëveprim të forcave antikomuniste të Shqipërisë së Mesme e të Veriut. Gjatë qeverisjes së Mustafa Krujes përveç se u hoqën nga flamuri shqiptar fashot e Liktorit, Plava dhe Guçia iu bashkuan Shqipërisë, nuk u zbatuan ligjeve raciale, rreth 300 familje hebrenjsh në Kosovë, që tashmë ishte pjesë e Shqipërisë, morën pasaporta shqiptare, u mbrojt ekonomia shqiptare dhe u dërguan kontingjente armatarësh në Kosovë. Ata që e shpallën Mustafa Krujen si armik, në atë pjesë të flamurit ku kishin qenë simbole fashiste, të cilat Ai i hoqi, vendosën, pesë muaj më vonë, në Konferencën e Pezës më 16 shtator 1942, një simbol tjetër të huaj: yllin bolshevik. Paskëta Mustafa Kruja u tërhoq nga politika aktive, duke parë se edhe nacionalistët po bashkëpunonin me komunistët. Sidoqoftë, ai i dha përkrahjen Lëvizjes së Legalitetit, në kuadër të

Ai është kronist i asaj kohe ku shquhet si atdhetar i flakët dhe si dëshmues serioz dhe i saktë, sepse siç na shënon Shejzat në shkrimin për vdekjen e tij "Deshti ma fort Shqipërinë se popullaritetin e vet"

luftës kundër komunizmit. Mërgoi nga një vend në tjetrin duke u marr me kërkime shkencore, deri sa ju dha strehim në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku dhe ndërroi jetë siç pamë më lartë më 27 Dhjetor 1958. Për të vlejën fjalët e Ernest Koliqit "Deshti ma fort Shqipërinë se popullaritetin e vet"

Për figura të tilla historia, gjatë këtyre 22 vjetëve, mendoj se ka pasur mjaft kohë për ta thënë fjalën e vet me objektivitet, pa pasion dhe kufizime apo tabu primitive politike dhe ideologjike. Pavarësisht nga kjo, do të jenë historianët dhe studiuesit e ardhshëm, të zhveshur nga indoktrinimi, interesat politike dhe inatet apo kryeneçësia tipike shqiptare, ata që do të thonë me drejtësi dhe paanësi fjalën për jetën dhe veprën e këtij atdhetari dhe shkencëtari të shquar në kompleksitetin e veprimtarisë së tij politike në dobi të interesave të atdheut. Ai është kronist i asaj kohe ku shquhet si atdhetar i flakët dhe si dëshmues serioz dhe i saktë, sepse siç na shënon Shejzat në shkrimin për vdekjen e tij "Deshti ma fort Shqipërinë se popullaritetin e vet".

Kruja, duke e quajtur qytetar nderi dhe me dhënie e emrit të tij sheshit kryesor të qytetit, ka nderuar jo vetëm një nga bijtë e tij më të mirë por, edhe veten.

Tiranë 23.11.2012

Fjala e mbajtur në konferencën për kujtimore më datë 24 nëntor 2012

PËRSHPAGIMET | PJESA II

Shqipëri etnike nën mbrojtjen italiane

Pjesa e dytë e dokumentave ekskluzive. Autorët e promemorisë së 1941, tregojnë kufijtë, numrin e banorëve dhe tendencën e sllavëve për të depërtuar në zonat shqiptare

Kjo është pjesa e dytë e "Përshpagimeve shqiptare", promemoria që u hartua për Ministrinë e Jashtme Italiane, me qëllim bashkimin e trojeve etnike shqiptare nën mbrojtjen italiane. Dokumentet që botohen për herë të parë tregojnë se si u përgatiti materiali i hollësishëm me argumenta historike, ekonomike, diplomatike etj, mbi padrejtësitë ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve dhe si duhej vënë drejtësi në vend... Komisioni hartues i këtyre dokumentave përbëhet nga Fejzi Alizoti, Dhimitër Berati, Xhemil Dino e Tahir Shtylla e kryesohet nga Mustafa Kruja, atëherë senator i Mbretërisë e Kryetar i Institutit të Studimeve shqiptare.

dustriale, së cilës i kushtoheshin me shumë elementët e krishterë t'asaj Perandorie që përbënin popullin rajà. Në dukurinë e këtyre depërtimeve sllave, të kushtuara tregëtisë e industrisë, të lejuara nga Perandoria otomane, Rusia Cariste shihte mjetin më të mirë politik për të përhapur idenë panslave, nëpërmjet krijimit të shteteve të krishterë në Turqinë evropiane, të cilët do të bënin qdo përpjekje për t'a zhbirë vetë Turqinë deri në përzënie nga Ballkani. Krijimi dhe zmadhimi i Shteteve ballkanike, të lidhur në qerren e Rusisë, do të çonte fatalisht në coptimin e territoreve shqiptare. Megjithatë, elementët sërbë e malazezë, të depërtuar në sektorin në fjalë deri në 1912, përfaqësojnë vetëm 5% të popullsisë së përgjithëshme; por ajo që meriton të vihet në dukje është fakti që, në qarqet e përfshira në këtë sektor, duke lënë mënjane rrethet e Shkupit, të Tetovës, Gostivarit e Kërçovës, as më parë e as mbresa 1912-ës, nuk rezulton asnjë element bulgaro-maqedon. Nga pikpamja etnike sektorët Veri e Veri-Lindje paraqiten, padyshim, të një fizionomije të mirëfilltë shqiptare. Kjo është e njohur për të gjithë e besoj se nuk është nevojja të jepen prova për të justifikuar kërkesat tona mbi këtë trevë. Na mjafton të rendisim këtu poshtë, në vënd të një dokumentimi të përmbledhur e në një formë

Dokumentet pjesa II

SHTOJCA Nº2
 SEKTORI VERIOR E VERI-LINDOR
 Ky sektor përmbledh krahinën e Kosovës, që rrethohet në Jugë nga vargmalet e Sharit dhe Karadagut dhe në Veri nga vija e jetër e kufirit turko-sërb para 1912-ës, po ashtu si rrethet e Preshevës, Kumanovës, Shkupit, Tetovës, Gostivarit e Kërçovës.

Në krahinën e Kosovës bëjnë pjesë rrethet e Peshterit, Rozhajës, Pejës, Novi-Pazarit, Mitrovicës, Vuçiternit, Prishtinës, Podujevës, Gjilanit, Ferizajt e Kaçanikut. Siç dihet, rrethet e mësipërme kontribuonin në formimin e Vilajetit të Shkupit që, së bashku me tre të tjerët, të Monastirit, Jaminës e Shkodrës ishin kërkuar nga populli shqiptar që nga Lidhja e Prizrenit për krijimin e Shqipërisë autonome.

I.KONSIDERATA ETNIKE

Nga pikëpamja etnike, popullsia e këtij sektori është kompaktësisht vëndase shqiptare, e nuk është rasti për t'i dhënë asnjë rëndësi atij numuri të pakët sllavësh (Sërb, Malazez e Bullgaro- Maqedonas), të depërtuar gjatë sundimit otoman. Ky, siç dihet, e lejonte këtë depërtim për nevojë të llojeve të ndryshme, me që traditat luftaraket të Perandorisë kishin bërë që nënshtetësit e besimit mysliman, që formonin popullin sovran, dalngadalë lanë mbas dore veprimtarinë tregtare e in-



Mustafa Merlika Kruja

me konçize, përshkrimin etnografik të sektorit, objekt të kësaj shtojce. Tre llojesh janë dokumentimet që na drejtojnë në ndriçimin të drejtave të shqiptarëve në Kosovë: a) përshkrimet e hartave etnografike; b) shqyrtimi i shifrave statistikore c) raporti i popullsisë shqiptare me numrimin e elementëve të huaj, t'ardhur këtu nëpërmjet depërtimeve. A) Hartat etnografike, të botuara nga autorët të huaj, edhe t'originisë sllave, janë të detyruara të njohin, në vija të përgjithëshme, fizionominë shqiptare të Kosovës. Këto harta, që janë riprodhuar në librin e D. Rizoff "Bullgarët në kufijtë e tyre historikë, etnografikë e politikë" (Berlin 1917 dhe në librin "Shqiptarët e Sllavët" të Lumo Skëndos, mund të quhen si variante...

PËRSHPAGIMET | PJESA II

vijon nga faqja 19

PROJEKTI I MUSOLINIT

"Si depërtuan sllavët në zonat shqiptare në veri e verilindje"

...të njëra tjetrës, duke ndryshuar mes tyre në ndonjë hollësi. Harta etnografike më e afërt është ajo e botuar nga Prof. J.I.Kettler (Flemming, Berlin 1919) e vërtetën të drejtat tona, në një kohë kur depërtimi sllav në Kosovë kish të filluar të jepte efektet e tij. Harta e Kettlerit, ashtu si dhe ajo e Kiepert (Berlin 1876) meritojnë, më shumë se të tjerat, të merren për bazë sepse janë punime të dy autorëve të shquar, që përbëjnë autoritet në fushën etnografike e, meqë të dy janë të kombësisë gjermane, quhen objektivisht të paanshëm. Simbas këtyre hartave, është territor i dukshëm shqiptar katërkëndëshi i përfshirë nga një vijë që, nga Veriu, shkon nga Novi-Pazarit e Leskovaci, në Lindje nga Leskovaci në Kumanovë - Shkup - Velezh, në Perëndim nga Novi - Pazarit e Gucia deri tek bregu skajor Veri-Perëndimor i liqenit të Shkodrës. Në librin e shkencëtarit italian Roberto Almaghà, të titulluar Albania (Romë 1930), në faqen 173, është futur një hartë e Shqipërisë që tregon zonat e banuara tërësisht prej shqiptarësh. N'atë hartë, zonat objekt të kësaj shtojte, janë të kufizuara nga një vijë që nis nga Novi-Pazarit, shkon nga Lindja duke marrë një kthesë të lehtë drejt Jugut, pastaj drejtohet nga skanji Verior afërsisht pranë rrethina të Nishit; zbrit drejt një pike të vendosur në Veri-Lindje të Vranjës, rikthehet nga Perëndimi, për të zbritur në drejtim të Jugut duke lënë jashtë Vranjën e vazhdon drejt Jugut, në drejtim të Monastirit, mbasi ka përfshirë Shkupin, Tetovën, Gostivarin e Kërçovën. Por hartat etnografike më interesante për tezën tonë janë ato të botuara më 1924, së bashku me librin mbi regjistrimin jugosllav të 1921; harta e parë, që është gjuhësore, tregon popullsitë shqiptare, ndërsa e dyta ato myslimane të ish Jugosllavisë. Simbas hartës gjuhësore, kufiri etnik kalon shumë në veri të Mitrovicës dhe shkon në drejtim Jugë-Lindje, afër Vranjës, duke përmblodhur Mitrovicën, Vuçiternin, Prishtinën, Podujevën e pastaj zbrit drejt Jugut, shumë në lindje të Gjilanit që përfshihet së bashku me Preshevën e Kumanovën; së fundi vija rrethon Shkupin e arrin rrethinat e Velezhit. Harta e dytë, ajo e popullsisë myslimane, përcakton të njëjtët kufij me ndryshimin që përfshin Novi-Pazarin dhe në gjithë zonën e Kosovës shënon një dendësi më të madhe, siç do t'a shohim më poshtë. B) - Shifrat statistikore: Simbas statistikave turke e austriake e simbas shumicës së autorëve, numuri i shqiptarëve, banorë të territoreve të ish Jugosllavisë, vërtitet rreth 800.000. Kjo popullsi banon në pjesën më të madhe në sektorin, objekt të kësaj shtojte. E dhe e statistika jugosllave e 1921-it na jep shifrën e 700.000 shqiptarëve, por i quan myslimanë. Me që në territorin e ish Jugosllavisë Turqit janë në numur shumë të pakët, mund të nxirret përfundimi se shifra e 700.000 myslimanëve përfaqëson numurin e shqiptarëve, pra statistika jugosllave, tërthoras, ka njohur të vërtetën etnike shqiptare. Nga ana tjetër, numuri i 441.000 banorëve të gjuhës shqipe, të shënuar nga statistika e mëparëshme jugosllave s'është tjetër veçse një fallifikim për të mbu-

luar këtë të vërtetë.

Statistika jugosllave që vazhdon më 1931, ndërsa bën fjalë për 546.000 shqiptarë, shton papritmas numurin e Turqëve, duke e çuar deri në rreth 200.000. Shuma e këtyre dy shifrave na jep një numur rreth 746.000, që duhen konsideruar shqiptarë, mbasi, në të vërtetë, numuri i Turqëve në Jugosllavi ka qenë gjithmonë i papërfillshëm dhe ata të pakët që kishin mbetur, më 1931, mërguan të gjithë në Turqi. Por qëllimi i përpiluesit jugosllav, n'atë rast, ishte të përligjte përzënieën e Shqiptarëve në Turqi, duke i quajtur Turq. Kjo përzënie gjeti në vazhdim shprehjen e saj konkrete në marrëveshjen turko - jugosllave të 1938-ës, në bazë të së cilës Turqia pranonte të strehonte në territorin e saj 250.000 t'ashtuquajtur Turq të Jugosllavisë. Mashttrimi jugosllav në këtë pikë është i dukshëm, si për ndryshimin që shihet mes statistikës të vitit 1921, në të cilën Turqit, sasi e papërfillshme, gjenden në shtyllën e folësve të gjuhëve të tjera dhe statistikës së vitit 1931, që e zmadhon numurin, duke e çuar në afër 200.000, gjithashtu për qëllimin e fshehtë që kishin serbët, të hiqnin qafet, me

çfarëdo çmimi pakicën shqiptare. Nëse serbët do të kishin patur kohë që të zbatonin plotësisht marrëveshjen turko - jugosllave të 1938-ës, mbi shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve, statistikave të ardhëshme jugosllave sigurisht do të rrisnin shifrën e Turqëve, përndryshe nuk shpërgohet shifra e 250.000 t'ashtuquajtur turq për t'u transferuar në Turqi, kur vetë statistika e 1931 tregon pothuajse 200.000. Një shikim librit të regjistrimit jugosllav të vitit 1921 na zbulon se qarqet, që formojnë sektorin tonë, janë të gjithë të banuar nga një shumicë dërmuese shqiptarësh. Për këtë mjafton të krahasohen dy shtyllat e myslimanëve (shqiptarë) dhe të serbo-kroatëve, nën emrin e të cilëve janë përfshirë të gjithë sllavët: Malazez, Boshnjakë, Kroatë, Serbë, Bullgarë e Shqiptarë të sllavizuar. Sa i përket këtyre të fundit, duhet të vemë në dukje se po të mbahej parasysh edhe numuri i tyre, shifra e përgjithshme e Shqiptarëve të ish Jugosllavisë do të kalonte milionin e banorëve. Shkruan prof. Antonio Baldaçi në librin e tij Shqipëria (Romë 1929) në faqen 178: " Si përfundim të hulumtimeve të mija llogaris se Shqipfolësit (përfshirë serbë-myslimanë-arnautë-shqiptarë që flasin pa dallim në shtëpi serbisht e shqip) e kalojnë në Jugosllavi milionin e njerzëve. Prej tyre, poqoj se 700.000 janë shqiptarë të mirëfilltë." Në të njëjtën vepër të Baldaçit gjejmë përkshkrimin

e disa qyteteve të Shqipërisë etnike, me veçoritë e tyre karakteristike e me shifrat e popullsisë të tyre.

C) Përmasat e popullsisë shqiptare -

Kemi thënë më sipër se, në rrethet e sektorit në fjalë, sasia e sllavëve të depërtuar para vitit 1912 përfaqësonte 5% të popullsisë së përgjithshme. Sado që mbas 1912-ës depërtimi sllav në Kosovë u shtua e Qeveria jugosllave do të bënte të pamundurën për t'a shtuar akoma më shumë atë, elementi shqiptar mundi të ruajë raportin pozitiv të epërsisë së tij. Kështu konstatohet se në Vuçitern, Prishtinë, Graçanik, Nerodmilje, Prizren, elementi mysliman (shqiptar) paraqitet me një shumicë dërmuese përballë elementit sllav, ndërsa në Drenicë, Llap, Podgorë, Podrinë, Has e Kaçanik ky përpjestim nuk mund të bëhet mes dy elementëve sllav e shqiptar, duke qenë sllavët në numur vërtetë të papërfillshëm. Po japim vetëm një shembull: në Kaçanik myslimanët shqiptarë (faqja 14 e statistikës jugosllave të 1921-it) janë 10.487 përballë vetëm 233 sllavëve.

Ky realitet i shkëlqyer që flet në dobi të shqiptarëve në Kosovë është fiksuar më mirë në hartat e bashkangjitura librit të regjistrimit jugosllav të 1921-it. Harta që tregon myslimanët (shqiptarët) e Kosovës paraqet pjesën më të madhe të zonave të sek-

it: 75-95% në rrethet e Kumanovës, Preshevës, Ferizajt, Prishtinës, Vuçiternit, Suharekës, Tetovës, Gostivarit e Kërçovës. Përkshkrimi i mësipërm është në vetvete mjaft shprehës.

Por për të qenë më të saktë shtojmë edhe një tjetër dëshmi, gjithmonë nga burime zyrtare Jugosllave: Këshilltari i Reformës Agrare Jugosllave Gjergj Krstiq, në librin e tij "Kolonizimi i Sërbisë Jugore (Sarajevo 1928)" zbulon shqetësimin e tij për dendësinë dhe kompaktësinë e elementit shqiptar në Kosovë, gjë që të cilën ai bëhet kundërshtuar skajor në programin e tij për zbatimin e Reformës agrare. Ky autor jep 72% Shqiptarë në Kosovë, kundrejt 24% sllavësh (faqe 78) e në Kaçanik vetëm 2,25 % të sllavëve kundrejt një shumice dërmuese shqiptare. Përsa i përket Shkupit, edhe se n'atë qytet elementi shqiptar nuk ka një shumicë absolute si në rrethet e tjera të këtij sektori, duhet mbajtur parasysh fakti se n'atë qytet e në rrethinat e tij kemi të bëjmë me një element që nuk gjendet në rrethet e Kosovës. Ky element është i përbërë nga Bullgaro - maqedonët. Këta, me sërëbt depërtues që nga 1912, e me Shqiptarët përbëjnë popullsinë e qytetit, në të cilën elementi shqiptar ka shumicën në krahasim me të tjerët dhe sasia e tij sot vërtitet rreth 30.000 vetëve që Bullgarët, duke ndjekur sistemin e përshtatur nga Qeveria e ish Jugosllavisë, kërkojnë t'i kalojnë për Turqi. Fakti i pranisë së elementit shqiptar në Shkup, meriton të vërtetohet.



Në foto: (Lart) Mustafa Kruja gjatë një vizite në Kosovë, 1942 (Majtas) Dy faksimile nga dokumentat e Promemories

(Serb e Bullgarë) do të japë një shifer më të vogël se ajo e Shqiptarëve. Do t'ishte e kotë të shtohet se shifra e 18.032 Shqiptarëve është më e ulët nga e vërteta që duhet të jetë ajo e 24.299 myslimanëve. Simbas hartave etnografike të shkencëtarëve e simbas atyre të shtypura nga statistikat jugosllave të 1921-it, nëse nga një anë në qytetin e Shkupit elementi shqiptar rezulton në një numur mjaft të vogël, nga ana tjetër zonat për rreth, madje edhe rrethinat e vetë qytetit janë të banuara nga shumica të forta shqiptare. Harta etnografike, e futur në librin e shkencëtarit italian Almagià, e përfshin qytetin e Shkupit në kufirin etnik shqiptar. Një tjetër hartë, e riprodhuar në faqen 182 të të njëjtët libër, tregon se fshatrat shqiptarë, që gjenden për rreth Shkupit, kanë shumicën absolute përkundërjt bullgarëve e serbëve: 56 fshatra shqiptarë kundrejt 14 bullgarëve e 9 serbëve. Kjo hartë pasqyron gjendjen ekzistuese në fund të sundimit otoman (1912).

(Vijon numrin e ardhëshëm)